

32002L0092

Direktiva 2002/92/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 9 dhjetor 2002, për ndërmjetësimin në sigurime

Gazeta Zyrtare L 009 , 15/01/2003 fq. 0003 - 0010

Direktiva 2002/92/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 9 dhjetor 2002, për ndërmjetësimin në sigurime

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 47 paragrafi 2 dhe nenin 55 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit [3],

Meqë:

(1) Ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime luajnë një rol qendror në shpërndarjen e produkteve të sigurimeve dhe risigurimeve në Komunitet.

(2) Hapi i parë drejt mundësimin të ushtrimit të lirisë së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime për agjentët dhe brokerët në sigurime është bërë me Direktivën e Këshillit 77/92/KEE, datë 13 dhjetor, për masat për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime në lidhje me veprimtaritë e agjentëve dhe brokerëve në sigurime (ish Grupi 630 i Klasifikimit Industrial Standard Ndërkombëtar) dhe, në veçanti, për masat kalimtare në lidhje me këto veprimtari[4].

(3) Direktiva 77/92/KEE duhej të ishte e zbatueshme deri në hyrjen në fuqi të dispozitave që bashkërendojnë rregullat kombëtare në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarive të agjentëve dhe brokerëve në sigurime.

(4) Rekomandimi i Komisionit 92/48/KEE, datë 18 dhjetor 1991, për ndërmjetësit në sigurime [5] në përgjithësi është respektuar nga Shtetet Anëtare dhe ka ndihmuar në përafrimin e dispozitave kombëtare për kërkesat profesionale dhe regjistrimin e ndërmjetësve në sigurime.

(5) Gjithsesi, ka ende dallime ndërmjet dispozitave kombëtare, të cilat krijojnë pengesa për fillimin dhe ndjekjen e veprimtarive të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime në tregun e brendshëm. Për rrjedhojë, del nevoja për ta zëvendësuar Direktivën 77/92/KEE me një direktivë të re.

(6) Është mirë që ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime të përfitojnë nga liria e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime, të cilat parashikohen në Traktat.

(7) Pamundësia e ndërmjetësve në sigurime për të ushtruar veprimtari lirisht në të gjithë Komunitetin e pengon funksionimin siç duhet të një tregu të vetëm në sigurime.

(8) Për rrjedhojë, bashkërendimi i dispozitave kombëtare për kërkesat profesionale dhe regjistrimin e personave që fillojnë dhe ndjekin veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime mund të kontribuojë, si për plotësimin e tregut të vetëm për shërbime financiare, ashtu edhe për rritjen e mbrojtjes së konsumatorëve në këtë fushë.

(9) Produktet e sigurimeve mund t'i shpërndajnë lloje të ndryshme personash ose institucionesh, si për shembull; agjentë, brokerë dhe subjekte "banka-sigurues". Barazia e trajtimit ndërmjet subjekteve dhe mbrojtjes së konsumatorëve kërkon që me këtë direktivë të mbulohen të gjithë këta persona ose institucione.

(10) Në këtë direktivë jepet një përkufizim i "ndërmjetësit të lidhur në sigurime", përkufizim i cili merr në konsideratë karakteristikat e tregjeve të Shteteve Anëtare të caktuara dhe ka për qëllim të vendosë kushtet për regjistrimin për këta ndërmjetës. Ky përkufizim nuk synon t'i pengojë Shtetet Anëtare që të kenë koncepte të ngjashme në lidhje me ndërmjetësit në sigurime të cilët, edhe pse veprojnë në emër dhe për llogari të një ndërmarrjeje sigurimesh dhe nën përgjegjësinë e plotë të kësaj ndërmarrjeje, kanë të drejtë të mbledhin prime apo shuma për llogari të konsumatorit në përputhje me garancitë financiare që parashikon kjo direktivë.

(11) Kjo direktivë është mirë që të zbatohet për personat veprimtaria e të cilëve konsiston në ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime, që mund të jetë marrëdhënie monetare ose mund të marrë një formë tjetër shpërblimi ekonomik të miratuar e të lidhur me rezultatet e punës.

(12) Kjo direktivë është mirë të mos zbatohet për personat me një veprimtari tjetër profesionale, siç janë ekspertët fiskalë ose kontabilistët, të cilët ofrojnë me raste këshilla lidhur me mbulimin me sigurime gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie tjetër profesionale, gjithashtu të mos zbatohet thjesht për ofrimin e informacioneve me natyrë të përgjithshme lidhur me produktet e sigurimeve, me kusht që kjo veprimtari të mos ushtrohet për ta ndihmuar klientin të lidhë apo përmbushë një kontratë sigurimi ose risigurimi, as për administrimin profesional të kërkesave për dëmshpërblim dhe as të mos zbatohet për vlerësimin e humbjeve dhe të kërkesave për dëmshpërblim nga ekspertët.

(13) Kjo direktivë është mirë të mos zbatohet për personat që e ushtrojnë ndërmjetësimin në sigurime si një veprimtari dytësore sipas disa kushteve të caktuara e të rrepta.

(14) Kërkohej që ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime të jenë të regjistruar pranë autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar ku kanë vendqëndrimin ose zyrën qendrore, me kusht që të përmbushin kërkesa të rrepta profesionale në lidhje me aftësinë, reputacionin e mirë, mbulimin me sigurim të përgjegjësive profesionale dhe aftësinë financiare.

(15) Është mirë që ky regjistrim t'u japë mundësi ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime të ushtrojnë veprimtari në Shtetet e tjera Anëtare në përputhje me parimet e lirisë së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, me kusht që ndërmjet autoriteteve kompetente të ndiqet një procedurë e duhur njoftimi.

(16) Nevojiten sanksionet e duhura për personat që e ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime pa u regjistruar, për ndërmarrjet e sigurimeve ose risigurimeve të cilat përdorin shërbimet e ndërmjetësve të paregjistruar dhe për ndërmjetësit që nuk i respektojnë dispozitat kombëtare të miratuara në zbatim të kësaj direktive.

(17) Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente është thelbësor për mbrojtjen e klientëve dhe për të siguruar gjendjen e shëndoshë të veprimtarisë së sigurimeve dhe risigurimeve në një treg të vetëm.

(18) Është thelbësore që klienti të ketë dijeni nëse ka të bëjë me një ndërmjetës i cili po e këshillon për produkte nga një gamë e gjerë ndërmarrjesh sigurimesh apo për produktet e ofruara vetëm nga një numër i caktuar ndërmarrjesh të sigurimeve.

(19) Është mirë që kjo direktivë të përcaktojë detyrimet që duhet të kenë ndërmjetësit në sigurime, gjatë dhënies së informacioneve klientëve. Në këtë fushë, Shteti Anëtar mund të mbajë në fuqi ose të miratojë dispozita më të shtrënguara të cilat mund të vendosen mbi ndërmjetësit në sigurime pavarësisht vendqëndrimit kur këta ushtrojnë veprimtaritë e ndërmjetësimit në territorin e tij, me kusht që këto dispozita më të shtrënguara të jenë në respektim të legjislacionit të Komunitetit, duke përfshirë edhe Direktivën 2000/31/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 8 qershor 2000, për disa aspekte ligjore të shërbimeve të shoqërisë së informacionit, në veçanti për tregtinë elektronike, në Tregun e Brendshëm (Direktiva për tregtinë elektronike) (6).

(20) Nëse ndërmjetësi deklaron se jep këshilla për produkte nga një gamë e gjerë ndërmarrjesh të sigurimeve, kërkohet që ai të bëjë një analizë të drejtë dhe mjaftueshmërisht të gjerë të produkteve që gjenden në treg. Krahas kësaj, është mirë që të gjithë ndërmjetësit të shpjegojnë arsyet mbi të cilat bazohen këshillat e tyre.

(21) Ka më pak nevojë për të kërkuar që ky informacion të bëhet i ditur kur klienti është një shoqëri tregtare që kërkon mbulim me risigurim ose sigurim të risqeve tregtare dhe industriale.

(22) Ekziston nevoja për të pasur procedura të përshtatshme dhe të efektshme për ankesat në Shtetet Anëtare në mënyrë që të zgjidhen mosmarrëveshjet ndërmjet ndërmjetësve në sigurime dhe klientëve, duke përdorur, sipas rastit, procedurat ekzistuese.

(23) Pa cenuar të drejtën e klientëve për të ngritur padi në gjykatë, është mirë që Shtetet Anëtare t'i nxisin organet publike ose private të krijuara me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës që këto të bashkëpunojnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkufitare. Për shembull, një bashkëpunim i tillë mund të synonte që t'u jepte mundësi klientëve për të kontaktuar organet jashtëgjyqësore të krijuara nga Shteti Anëtar ku kanë vendqëndrimin, në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me ndërmjetësit në

sigurime të vendosur në Shtete Anëtare të tjera. Ngritja e rrjetit FIN-NET e rrit asistencën që u jepet konsumatorëve kur këta përdorin shërbime ndërkufitare. Është mirë që dispozitat për procedurat të marrin në konsideratë Rekomandimin e Komisionit 98/257/KE, datë 30 mars 1998, për parimet e zbatueshme për organet përgjegjëse për zgjidhjen jashtë gjykatave të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve [7].

(24) Për rrjedhojë, kërkohet të shfuqizohet Direktiva 77/92/KEE,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

KAPITULLI I

FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Fusha e veprimit

1. Në këtë direktivë parashikohen rregullat për fillimin dhe ndjekjen e veprimtarive të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga personat fizikë dhe juridikë të vendosur në një Shtet Anëtar ose që dëshirojnë të vendosen në një Shtet Anëtar.

2. Kjo direktivë nuk zbatohet për personat që ofrojnë shërbime ndërmjetësimi për kontratat e sigurimeve, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) kontrata e sigurimit kërkon vetëm vënien në dijeni për mbulimin me sigurim që ofrohet;

(b) kontrata e sigurimit nuk është kontratë e sigurimit të jetës;

(c) kontrata e sigurimit nuk mbulon risqe të përgjegjësive;

(d) veprimtaria parësore profesionale e personit nuk është ndërmjetësim në sigurime;

(e) sigurimi është plotësues për produktin ose shërbimin e furnizuar nga një ofrues, ku ky sigurim mbulon:

(i) riskun e defektit, humbjes ose dëmtimit të mallrave të furnizuara nga ofruesi, ose

(ii) dëmtimin ose humbjen e bagazheve dhe risqe të tjera të lidhura me udhëtimet e rezervuara pranë ofruesit, edhe sikur sigurimi të mbulojë sigurimin e jetës apo risqe të përgjegjësive, me kusht që ky mbulim të jetë ndihmës ndaj mbulimit kryesor për risqet e lidhura me udhëtimin;

(f) shuma e primit vjetor nuk është më e madhe se 500 euro dhe periudha e vlefshmërisë së kontratës së sigurimit, përfshirë edhe rinovimet, nuk është më shumë se pesë vjet.

3. Kjo direktivë nuk zbatohet për shërbimet e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime të ofruara në lidhje me risqet dhe angazhimet që ndodhen jashtë Komunitetit.

Kjo direktivë nuk e prek legjislacionin e Shtetit Anëtar në lidhje me veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime të ndjekur nga ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime të vendosur në një vend të tretë të cilët ushtrojnë veprimtari në territorin e tij sipas parimit të lirisë për të ofruar shërbime, me kusht që të garantohet trajtim i barabartë për të gjithë personat që ushtrojnë ose autorizohen të ushtrojnë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime në këtë treg.

Kjo direktivë nuk i rregullon veprimtaritë e ndërmjetësimit në sigurime të ushtruara në vendet e treta dhe as veprimtaritë e ndërmarrjeve të sigurimeve ose risigurimit të Komunitetit, të përkufizuara në Direktivën e Parë të Këshillit, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarive të sigurimeve të drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës [8] dhe në Direktivën e Parë të Këshillit 79/267/KEE, datë 5 mars 1979, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë të jetës [9], të ushtruara nëpërmjet ndërmjetësve në sigurime në vendet e treta.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj direktive:

1. "ndërmarrje sigurimesh" është ndërmarrja që ka marrë autorizimin zyrtar në përputhje me nenin 6 të Direktivës 73/239/KEE ose nenin 6 të Direktivës 79/267/KEE;
2. "ndërmarrje risigurimi" është ndërmarrja që nuk është ndërmarrje sigurimesh, nuk është ndërmarrje sigurimesh e një vendi jo-anëtar, dhe që veprimtaria kryesore tregtare e së cilës është pranimi i risqeve të ceduara nga një ndërmarrje sigurimesh, një ndërmarrje sigurimesh e një vendi jo-anëtar ose nga ndërmarrje të tjera risigurimi;
3. "ndërmjetësimi në sigurime" janë veprimtaritë e prezantimit, propozimit ose kryerjes së punës përgatitore deri në lidhjen e kontratave të sigurimeve, ose veprimtaritë për lidhjen e këtyre kontratave, ose veprimtaritë e dhënies së asistencës për administrimin dhe përmbushjen e këtyre kontratave, sidomos në rastin e një dëmi.

Këto veprimtari, kur ushtrohen nga një ndërmarrje sigurimesh ose nga një punonjës i një ndërmarrjeje sigurimesh i cili vepron nën përgjegjësinë e ndërmarrjes së sigurimeve, nuk konsiderohen ndërmjetësim në sigurime.

Ndërmjetësim në sigurime nuk konsiderohet as dhënia e informacioneve jo në mënyrë sistematike në kuadër të një veprimtarie tjetër profesionale, nëse qëllimi i kësaj veprimtarie tjetër nuk është asistenca për klientin në lidhjen ose përmbushjen e një kontrate sigurimi, administrimi i kërkesave për dëmshpërbim të një ndërmarrjeje sigurimesh në mënyrë profesionale dhe vlerësimi i humbjeve dhe i kërkesave për dëmshpërblim;

4. "ndërmjetësimi në risigurime" janë veprimtaritë e prezantimit, propozimit ose kryerjes së punës përgatitore deri në lidhjen e kontratave të risigurimit, ose veprimtaritë për lidhjen e

këtyre kontratave, ose veprimtaritë e dhënies së asistencës për administrimin dhe përmbushjen e këtyre kontratave, sidomos në rastin e një dëmi.

Këto veprimtari, kur ushtrohen nga një ndërmarrje risigurimi ose nga një punonjës i një ndërmarrjeje risigurimi i cili vepron nën përgjegjësinë e ndërmarrjes së risigurimit, nuk konsiderohen ndërmjetësim në risigurime.

Ndërmjetësim në risigurime nuk konsiderohet as dhënia e informacioneve jo në mënyrë sistematike në kuadër të një veprimtarie tjetër profesionale, nëse qëllimi i kësaj veprimtarie tjetër nuk është asistencë për klientin në lidhjen ose përmbushjen e një kontrate risigurimi, administrimi i kërkesave për dëshmpërblim të një ndërmarrjeje risigurimi në mënyrë profesionale dhe vlerësimi i humbjeve dhe i kërkesave për dëshmpërblim;

5. "ndërmjetës në sigurime" është çdo person fizik ose juridik i cili, kundrejt një shpërblimi, fillon ose ndjek ndërmjetësimin në sigurime;

6. "ndërmjetës në risigurime" është çdo person fizik ose juridik i cili, kundrejt një shpërblimi, fillon ose ndjek ndërmjetësimin në risigurime;

7. "ndërmjetësi i lidhur në sigurime" është çdo person që ushtron veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime në emër dhe për llogari të një ose më shumë ndërmarrjesh të sigurimeve në rastin e produkteve të sigurimeve të cilat nuk konkurrojnë, por që nuk mbledh prime apo shuma për llogari të klientit, dhe që vepron nën përgjegjësinë e plotë të ndërmarrjeve në fjalë për produktet që u takojnë përkatësisht atyre.

Çdo person që ushtron veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime krahas veprimtarisë parësore profesionale konsiderohet gjithashtu si ndërmjetës i lidhur në sigurime që vepron nën përgjegjësinë e plotë të një ose disa ndërmarrjeve të sigurimeve për produktet që u përkasin atyre përkatësisht, nëse sigurimet janë një produkt plotësues për mallrat ose shërbimet e furnizuara në kuadër të kësaj veprimtarie parësore profesionale dhe nëse personi nuk arkëton prime apo shuma për llogari të klientit;

8. "risqe të mëdha" janë ato sipas përkufizimit në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës 73/239/KEE;

9. "Shteti Anëtar i origjinës" është:

(a) kur ndërmjetësi është person fizik, Shteti Anëtar ku ka vendqëndrimin dhe ku ushtron veprimtarinë tregtare;

(b) kur ndërmjetësi është person juridik, Shteti Anëtar ku ka selinë e regjistruar ose, nëse legjislacioni kombëtar nuk parashikon seli të regjistruar, Shteti Anëtar ku ka zyrën qendrore;

10. "Shteti Anëtar pritës" është Shteti Anëtar ku ndërmjetësi në sigurime ose risigurime ka një degë ose ofron shërbime;

11. "autoritetet kompetente" janë autoritetet e caktuara nga secili Shtet Anëtar sipas nenit 7;

12. "mjet rezistent" është çdo instrument i cili i jep mundësi klientit të ruajë informacionin që i është drejtuar personalisht atij, në mënyrë që të jetë e mundur të shihet dhe të përdoret për një periudhë kohore të mjaftueshme për qëllimet e informacionit, dhe i cili mundëson riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur.

Në veçanti, në mjetet rezistente përfshihen disqet magnetike (floppy disk), disqet kompakte (CD-ROM), disqet e videos dixhitale (DVD) dhe disqet e forta (hard drive) të kompjuterëve personalë në të cilët ruhet posta elektronike, por nuk përfshihen hapësirat në internet, me përjashtim të rastit kur hapësira në internet përmbush kriteret e përcaktuara në paragrafin e parë.

KAPITULLI II

KËRKESAT PËR REGJISTRIMIN

Neni 3

Regjistrimi

1. Ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime regjistrohen pranë autoritetit kompetent të parashikuar në nenin 7 pika 2, në Shtetin Anëtar të origjinës.

Pa cenuar paragrafin e parë, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që ndërmarrjet e sigurimeve dhe risigurimeve dhe organet e tjera të mund të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente për regjistrimin e ndërmjetësve në sigurimeve dhe risigurime dhe për zbatimin e kërkesave të nenit 4 për këta ndërmjetës. Në veçanti, në rastin e ndërmjetësve të lidhur në sigurime, këta mund të regjistrohen nga ndërmarrja e sigurimeve ose nga shoqata e ndërmarrjeve të sigurimeve, nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent.

Nuk është nevojshme që Shtetet Anëtare të zbatojnë kërkesën e përmendur në paragrafin e parë dhe të dytë, për të gjithë personat fizikë që punojnë në një ndërmarrje dhe që ndjekin veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime.

Sa u takon personave juridikë, Shtetet Anëtare i regjistrojnë këta persona dhe specifikojnë në regjistër edhe emrat e personave fizikë anëtarë të administrimit të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë tregtare të ndërmjetësimit.

2. Shtetet Anëtare mund të krijojnë më shumë se një regjistër për ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime, me kusht që të përcaktojnë kriteret sipas të cilave do të regjistrohen ndërmjetësit.

Shtetet Anëtare kujdesen që të ngrihet një pikë e vetme informimi, për të mundësuar informim të shpejtë dhe të lehtë nga këto regjistra të ndryshme, të cilët përpilohen në mënyrë elektronike dhe mbahen të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme. Kjo pikë informimi jep edhe të dhënat identifikuese për autoritetet kompetente të secilit Shtet Anëtar të përmendura në pikën 1 paragrafi i parë. Në regjistër bëhet e ditur edhe vendi ose vendet ku ushtron veprimtari ndërmjetësi sipas rregullave të lirisë së vendosjes ose lirisë për të ofruar shërbime.

3. Shtetet Anëtare sigurojnë që regjistrimi i ndërmjetësve në sigurime (duke përfshirë edhe ata të lidhur) dhe i ndërmjetësve në risigurime t'i nënshtrohet plotësimit të kërkesave profesionale të parashikuara në nenin 4.

Shtetet Anëtare sigurojnë edhe që ndërmjetësit në sigurime (duke përfshirë edhe ata të lidhur) dhe ndërmjetësit në risigurime që nuk i plotësojnë më këto kërkesa të çregjistrohen. Vlefshmëria e regjistrimit i nënshtrohet shqyrtimit të rregullit nga ana e autoritetit kompetent. Shteti Anëtar i origjinës, nëse është nevoja, e informon për çregjistrimin Shtetin Anëtar pritës, duke përdorur mënyrat e duhura.

4. Autoritetet kompetente mund t'i pajisin ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime me një dokument që u jep mundësi palëve të interesuara për të parë regjistrin ose regjistrat e përmendur në pikën 2, për të verifikuar se janë të regjistruar në mënyrë të ligjshme.

Në dokument jepen, si minimum, informacionet e përcaktuara në nenin 12 pika 1 shkronja "a" dhe "b" dhe, në rastin e personave juridikë, emri ose emrat e personit ose personave fizikë të përmendur në paragrafin e katërt të pikës 1 të këtij neni.

Shteti Anëtar kërkon kthimin e dokumentit tek autoriteti kompetent që e ka lëshuar, kur ndërmjetësi në sigurime ose risigurime në fjalë nuk është më i regjistruar.

5. Ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime lejohen të fillojnë dhe ndjekin veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime në Komunitet në kuadër të lirisë së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime.

6. Shtetet Anëtare sigurojnë që ndërmarrjet e sigurimeve të përdorin vetëm shërbimet e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime të ndërmjetësve të regjistruar në sigurime dhe risigurime të përmendur në nenin 1 pika 2.

Neni 4

Kërkesat profesionale

1. Ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime duhet të zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura, të përcaktuara nga Shteti Anëtar i origjinës i ndërmjetësit.

Shtetet Anëtare të origjinës mund t'i përshtatin kushtet në lidhje me njohuritë dhe aftësitë, në përputhje me veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe me produktet e shpërndara, sidomos nëse veprimtaria profesionale parësore e ndërmjetësit nuk është ndërmjetësimi në sigurime. Në këto raste, ky ndërmjetës mund ta ushtrojë veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime vetëm nëse përgjegjësinë e plotë për veprimet e tij e merr përsipër një ndërmjetës në sigurime që i përmbush kushtet e këtij neni ose një ndërmarrje sigurimesh.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që për rastet e përmendura në nenin 3 pika 1 paragrafi i dytë ndërmarrja e sigurimeve të verifikojë që njohuritë dhe aftësitë e ndërmjetësve të jenë në përputhje me detyrimet e parashikuara në paragrafin e parë të kësaj pike dhe, nëse është nevoja, t'u japë këtyre ndërmjetësve trajnim që përkon me kërkesat që kanë të bëjnë me produktet që ata shesin.

Nuk është e nevojshme që Shtetet Anëtare të zbatojnë kërkesën e përmendur në paragrafin e parë të kësaj pike për të gjithë personat fizikë që punojnë në një ndërmarrje dhe që ndjekin veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime. Shtetet Anëtare sigurojnë që një përqindje e arsyeshme e personave brenda strukturës së administrimit të këtyre ndërmarrjeve që janë përgjegjës për ndërmjetësimin në lidhje me produktet e sigurimeve dhe të gjithë personat e tjerë që janë të angazhuar drejtpërdrejt në ndërmjetësimin në sigurime ose risigurime të dëshmojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre.

2. Ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime duhet të kenë reputacion të mirë. Si minimum, ata duhet të jenë pa precedent penal ose, sipas kërkesave kombëtare, të mos kenë kryer vepra të rënda penale të lidhura me krimet kundër pronës ose me krimet e lidhura me veprimtaritë financiare dhe nuk duhet të jenë shpallur në procedurë falimentimi në të shkuarën, me përjashtim të rastit kur janë rehabilituar në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Shtetet Anëtare, në përputhje me dispozitat e nenit 3 pika 1 paragrafi i dytë, mund t'i lejojnë ndërmarrjet e sigurimeve të kontrollojnë reputacionin e mirë të ndërmjetësve në sigurime.

Nuk është e nevojshme që Shtetet Anëtare të zbatojnë kërkesën e përmendur në paragrafin e parë të kësaj pike për të gjithë personat fizikë që punojnë në një ndërmarrje dhe që ndjekin veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime. Shtetet Anëtare sigurojnë që këtë kërkesë ta përmbushë struktura e administrimit të këtyre ndërmarrjeve dhe personeli i angazhuar drejtpërdrejt në ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime.

3. Ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime duhet të kenë sigurim të përgjegjësive profesionale për të gjithë territorin e Komunitetit ose një formë të ngjashme garancie kundrejt përgjegjësive civile që lindin nga pakujdesia profesionale, për të paktën 1 000 000 euro për çdo kërkesë për dëmshpërblim dhe për 1 500 000 euro gjithsej në vit për të gjitha kërkesat për dëmshpërblim, nëse një sigurim apo garanci të tillë nuk e ka vendosur në dispozicion më parë ndërmarrja e sigurimeve, ndërmarrja e risigurimit ose ndonjë ndërmarrje tjetër për llogari të së cilës vepron ndërmjetësi në sigurime ose risigurime apo për të cilën i është dhënë tagri për të vepruar ndërmjetësit në sigurime ose risigurime ose nëse ndërmarrja në fjalë nuk e ka marrë përsipër përgjegjësinë e plotë për veprimet e ndërmjetësit.

4. Shtetet Anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i mbrojtur klientët nga pamundësia e ndërmjetësit në sigurime për t'ia kaluar primin ndërmarrjes së sigurimeve apo për t'ia kaluar shumën e dëmshpërblimit apo primin e kthyer personit të siguruar.

Këto masa marrin njëërën ose disa prej këtyre formave:

(a) dispozita të parashikuara me ligj ose kontratë në zbatim të të cilave fondet që klienti ia paguan ndërmjetësit trajtohen sikur t'i jenë paguar ndërmarrjes, ndërsa fondet që ndërmarrja ia paguan ndërmjetësit nuk trajtohen sikur t'i jenë paguar klientit deri në momentin kur klienti i merr faktikisht ato;

(b) kërkesa që ndërmjetësit në sigurime të kenë zotësi financiare që arrin në çdo moment nivelin prej 4% të shumës së primeve vjetore të arkëtuara, por asnjëherë më pak se 15 000 euro;

(c) kërkesa që fondet e klientëve të transferohen nëpërmjet llogarive rreptësisht të veçuara të klientëve dhe që këto llogari të mos përdoren për të rimbursuar kreditorët e tjerë në rast falimentimi;

(d) kërkesa për krijimin e një fondi garancie.

5. Ndjekja e veprimtarive të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime kërkon që kërkesat profesionale të parashikuara në këtë nen të plotësohen në çdo moment.

6. Shtetet Anëtare mund t'i përforcojnë kërkesat e parashikuara në këtë nen ose të shtojnë kërkesa të tjera për ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime të regjistruar në juridiksionin e tyre.

7. Shumat e përmendura në pikën 3 dhe 4 shqyrtohen rregullisht për të marrë në konsideratë ndryshimet e Indeksit European të Çmimit të Konsumatorit të publikuar nga Eurostat. Shqyrtimi i parë bëhet pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive, ndërsa shqyrtimet e mëpasshme çdo pesë vjet pas datës së shqyrtimit të mëparshëm.

Shumat përshtaten automatikisht duke e zmadhuar shumën bazë në euro me ndryshimin në përqindje të Indeksit të lartpërmendur gjatë periudhës nga hyrja në fuqi e kësaj direktive deri në datën e shqyrtimit të parë ose nga data e shqyrtimit të fundit deri në datën e shqyrtimit të ri, duke e rrumbullakosur në euron më të afërt.

Neni 5

Mbajtja e të drejtave të fituara

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që personat të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit përpara datës 1 shtator 2000, janë të regjistruar dhe kanë nivel trajnimi dhe përvoja të ngjashëm me atë që kërkon kjo direktivë të regjistrohen automatikisht në regjistrin që do të krijohet, nëse përmbushen kërkesat e parashikuara në nenin 4 pika 3 dhe 4.

Neni 6

Njoftimi i vendosjes dhe shërbimeve në Shtetet Anëtare të tjera

1. Çdo ndërmjetës në sigurime ose risigurime që synon të ushtrojë veprimtari tregtare për herë të parë në një ose disa Shtete Anëtare në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime ose të lirisë së vendosjes informon autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës.

Brenda një muaji prej njoftimit në fjalë, autoritetet kompetente informojnë autoritetet kompetente të çdo Shteti Anëtar pritës që dëshirojnë të jenë në dijeni, në lidhje me synimin e ndërmjetësit në sigurime ose risigurime, dhe në të njëjtën kohë informojnë edhe ndërmjetësin në fjalë.

Ndërmjetësi në sigurime ose risigurime mund ta fillojë veprimtarinë tregtare një muaj pas datës kur ka marrë informim lidhur me njoftimin e përmendur në paragrafin e dytë nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës. Megjithatë, ky ndërmjetës mund ta fillojë

menjëherë veprimtarinë tregtare nëse Shteti Anëtar pritës nuk dëshiron të informohet për këtë fakt.

2. Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin për dëshirën e tyre për të qenë të informuar në përputhje me pikën 1 Komisioni, nga ana e tij, i njofton për këtë të gjitha Shtetet Anëtare.

3. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar pritës mund të marrin hapat e nevojshëm për të siguruar publikimin e duhur të kushteve me të cilat duhet ushtruar në territorin e tyre veprimtaria në fjalë, në interesin e të mirës së përgjithshme.

Neni 7

Autoritetet kompetente

1. Shtetet Anëtare caktojnë autoritetet kompetente të cilave u jepet kompetenca për të siguruar vënien në zbatim të kësaj direktive. Ato e informojnë për këtë Komisionin, duke bërë të ditur edhe ndarjen e detyrave.

2. Autoritetet e përmendura në pikën 1 janë autoritete publike ose organe të njohura nga ligji i vendit ose nga autoritetet publike, dhe të cilave u jepen shprehimisht kompetencat për këtë qëllim nga ligji i vendit. Këto autoritete nuk mund të jenë ndërmarrje sigurimesh ose ndërmarrje risigurimi.

3. Autoriteteve kompetente u jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për kryerjen e detyrave. Kur ka më shumë se një autoritet kompetent në territorin e një Shteti Anëtar, ky Shtet Anëtar siguron që këto autoritete të bashkëpunojnë nga afër në mënyrë që të mund t'i përmbushin në mënyrë të efektshme detyrat përkatëse të tyre.

Neni 8

Sanksionet

1. Shtetet Anëtare parashikojnë sanksionet e duhura për ato raste kur personi që ushtron veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime ose risigurime nuk është i regjistruar në asnjë Shtet Anëtar dhe nuk është i parashikuar në nenin 1 pika 2.

2. Shtetet Anëtare parashikojnë sanksionet e duhura për ato ndërmarrje sigurimesh ose risigurimi të cilat përdorin shërbimet e personave të peregjistruar në asnjë Shtet Anëtar dhe të paparashikuar në nenin 1 pika 2.

3. Shtetet Anëtare parashikojnë sanksionet e duhura për ato raste kur ndërmjetësi në sigurime ose risigurime nuk i respekton dispozitat kombëtare të miratuara në zbatim të kësaj direktive.

4. Kjo direktivë nuk e cenon kompetencën e Shtetit Anëtar pritës për të marrë masat e duhura për parandalimin ose ndëshkimin e parregullsive të kryera brenda territorit të tij të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore apo rregullatore të miratuara në interes të së mirës së përgjithshme. Këtu përfshihet edhe mundësia për të mos i lejuar ndërmjetësit në sigurime ose risigurime që të hapin veprimtari të tjera në territorin në fjalë.

5. Çdo masë e miratuar, që përfshin sanksione ose kufizime të veprimtarive të ndërmjetësit në sigurime ose risigurime, duhet argumentuar siç duhet dhe i duhet komunikuar ndërmjetësit në fjalë. Kundër çdo mase të tillë mund të bëhet ankesë pranë gjykatës në Shtetin Anëtar që e ka miratuar masën.

Neni 9

Shkëmbimi i informacionit mes Shteteve Anëtare

1. Autoritetet kompetente të Shteteve të ndryshme Anëtare bashkëpunojnë për të siguruar zbatimin e duhur të dispozitave të kësaj direktive.

2. Autoritetet kompetente shkëmbejnë informacione për ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime nëse këta ndërmjetës kanë qenë objekt i një sanksioni të përmendur në nenin 8 pika 3 ose i një mase të përmendur në nenin 8 pika 4 dhe nëse një informacion i tillë ka të ngjarë të sjellë çregjistrimin nga regjistri kë ndërmjetësve të tillë. Autoritetet kompetente mund të shkëmbejnë, me kërkesën e një autoriteti, edhe çdo informacion tjetër me rëndësi.

3. Të gjithë personat të cilëve u kërkohet të marrin apo të japin informacion në lidhje me këtë Direktivë janë objekt i detyrimit të sekretit profesional, njësoj siç është parashikuar në nenin 16 të Direktivës së Këshillit 92/49/KEE, datë 25 shkurt 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës dhe për ndryshimin e Direktivave 73/239/KEE dhe 88/357/KEE (direktiva e tretë për sigurimet jo-jetës)[10] dhe nenin 15 të Direktivës së Këshillit 92/96/KEE, datë 10 nëntor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë të jetës dhe për ndryshimin e Direktivave 79/267/KEE dhe 90/619/KEE (direktiva e tretë për sigurimin e jetës)[11].

Neni 10

Ankesat

Shtetet Anëtare sigurojnë që të vendosen procedura të cilat t'u japin mundësi klientëve dhe palëve të tjera të interesuara, sidomos shoqatave të konsumatorëve, të regjistrojnë ankesa për ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime. Në të gjitha rastet, ankesat duhet të marrin përgjigje.

Neni 11

Zgjidhja jashtë gjykatës e mosmarrëveshjeve

1. Shtetet Anëtare nxisin vendosjen e procedurave të duhura dhe të efektshme të ankimit për zgjidhjen jashtë gjykatës të mosmarrëveshjeve midis ndërmjetësve në sigurime dhe klientëve, duke përdorur, sipas rastit, organet ekzistuese.

2. Shtetet Anëtare i nxisin këto organe që të bashkëpunojnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkufitare.

KAPITULLI III

KËRKESAT PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT NGA NDËRMJETËSIT

Neni 12

Informacioni që jep ndërmjetësi në sigurime

1. Përpara lidhjes së kontratës fillestare të sigurimit dhe, nëse duhet, në momentin e ndryshimit ose të rinovimit të kontratës së sigurimit, ndërmjetësi në sigurime i jep klientit të paktën informacionet e mëposhtme:

- (a) identitetin dhe adresën e vet;
- (b) regjistrin ku është i regjistruar dhe mënyrën si mund të verifikohet që është i regjistruar;
- (c) nëse ka pjesëmarrje, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që përfaqëson më shumë se 10 për qind të të drejtave të votës ose të kapitalit në një ndërmarrje të caktuar sigurimesh;
- (d) nëse një ndërmarrje e caktuar sigurimesh ose një ndërmarrje mëmë e një ndërmarrjeje të caktuar sigurimesh ka pjesëmarrje, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që përfaqëson më shumë se 10 për qind të të drejtave të votës ose të kapitalit në ndërmjetësin në sigurime;
- (e) procedurat e përmendura në nenin 10 që i japin mundësi klientit dhe palëve të tjera të interesuara të regjistrojnë ankesë për ndërmjetësin në sigurime dhe risigurime dhe, sipas rastit, për procedurat e zgjidhjes jashtë gjykatës të ankesave të përmendura në nenin 11.

Gjithashtu, ndërmjetësi në sigurime e informon klientin, lidhur me kontratën që ofrohet, nëse:

- (i) jep këshilla në bazë të detyrimit të parashikuar në pikën 2 për të bërë një analizë të drejtë ose
- (ii) ka detyrim kontraktor për ta ushtruar veprimtarinë tregtare të ndërmjetësisimit në sigurime vetëm për një ose disa ndërmarrje sigurimesh. Në këtë rast, me kërkesë të klientit ai bën të ditur emrat e këtyre ndërmarrjeve të sigurimeve, ose
- (iii) nuk ka detyrim kontraktor për ta ushtruar veprimtarinë tregtare të ndërmjetësisimit në sigurime vetëm për një ose disa ndërmarrje sigurimesh dhe nuk jep këshilla në bazë të detyrimit të parashikuar në pikën 2 për të bërë një analizë të drejtë. Në këtë rast, me kërkesë të klientit ai bën të ditur emrat e ndërmarrjeve të sigurimeve për të cilat i lejohet ta ushtrojë dhe e ushtron veprimtarinë tregtare.

Në rastin kur informacioni parashikohet të jepet vetëm me kërkesë të klientit, klienti informohet për të drejtën e tij për ta kërkuar një informacion të tillë.

2. Kur ndërmjetësi në sigurime e informon klientin se këshillat i jep në bazë të një analize të drejtë, ai është i detyruar t'i japë këto këshilla në bazë të një analize të një numri mjaftueshmërisht të madh kontratash sigurimi që ofrohen në treg, për t'i dhënë mundësi të japë një rekomandim, në përputhje me kriteret profesionale, se cila kontratë sigurimi do t'i përmbushte në mënyrë të mjaftueshme nevojat e klientit.

3. Përpara lidhjes së një kontrate të caktuar, ndërmjetësi në sigurime specifikon, të paktën dhe sidomos në bazë të informacioneve që jep klienti, kërkesat dhe nevojat e këtij klienti si edhe arsyet bazë për çdo këshillë që i jep klientit për një produkt të caktuar sigurimesh. Këto informacione modulohen sipas kompleksitetit të kontratës së sigurimit që propozohet.

4. Informacionet e përmendura në pikën 1, 2 dhe 3 nuk është e nevojshme të jepen nëse ndërmjetësi në sigurime ndërmjetëson në sigurimin e risqeve të mëdha dhe nëse bëhet ndërmjetësim nga ndërmjetësit në risigurime.

5. Shtetet Anëtare mund të mbajnë në fuqi ose të miratojnë dispozita më të rrepta në lidhje me kërkesat për informimin të përmendura në pikën 1, me kusht që këto dispozita të jenë në përputhje me legjislacionin e Komunitetit.

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dispozitat kombëtare të parashikuara në paragrafin e parë.

Për të arritur një nivel të lartë transparence përmes të gjitha mjeteve të duhura, Komisioni siguron që informacioni që merr në lidhje me dispozitat kombëtare t'u komunikohet edhe klientëve dhe ndërmjetësve në sigurime.

Neni 13

Kushtet për informimin

1. Të gjitha informacionet që u jepen klientëve në përputhje me nenin 12 komunikohen:

(a) në letër ose në një mjet tjetër rezistent i cili mund të shfrytëzohet dhe të përdoret nga klienti;

(b) në mënyrë të qartë dhe të saktë dhe të kuptueshme për klientin;

(c) në gjuhën zyrtare të Shtetit Anëtar të angazhimit ose në një gjuhë tjetër për të cilën bien dakord palët.

2. Në shmangie të pikës 1 shkronja "a", informacionet e përmendura në nenin 12 mund të jepen gojarisht nëse këtë e kërkon klienti ose nëse është i nevojshëm mbulimi i menjëhershëm. Në këto raste, informacioni i jepet klientit në përputhje me pikën 1 menjëherë pas lidhjes së kontratës së sigurimit.

3. Në rastin e shitjeve përmes telefonit, informacioni paraprak i jepet klientit në përputhje me rregullat e Komunitetit që zbatohen për marketingun në distancë të shërbimeve financiare të konsumatorit. Gjithashtu, informacioni i jepet klientit në përputhje me pikën 1 menjëherë pas lidhjes së kontratës së sigurimit.

KAPITULLI IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës

Shtetet Anëtare sigurojnë që kundër vendimeve të marra në lidhje me një ndërmjetës në sigurime, ndërmjetës në risigurime apo një ndërmarrje sigurimesh në bazë të akteve ligjore, nënligjore dhe administrative të miratuara në përputhje me këtë direktivë të mund të bëhet ankesë në gjykatë.

Neni 15

Shfuqizimi

Direktiva 77/92/KEE shfuqizohet më datën e përmendur në nenin 16 pika 1.

Neni 16

Transpozimi

1. Shtetet Anëtare miratojnë dhe zbatojnë akte ligjore, nënligjore dhe administrative të cilat janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ligjore të kësaj direktive brenda datës 15 janar 2005. Shtetet Anëtare njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Këto masa përfshijnë një tekst referues që bën lidhjen me këtë direktivë ose i shoqërojnë ato me një tekst të tillë referues kur t'i botojnë zyrtarisht. Mënyrat e përfshirjes së një teksti të tillë referues përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që miratojnë në fushën që rregullon kjo direktivë. Komunikimit i bashkëlidhet një tabelë ku bëhen të ditura se cilat dispozita kombëtare përkojnë me këtë Direktivë.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi ditën kur publikohet në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 18

Të adresuarit

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 9 dhjetor 2002.

Për Parlamentin European

Presidenti

P. COX

Për Këshillin

Presidenti

H. C. Schmidt

[1] GZ C 29 E, 30.1.2001, f. 245.

[2] GZ C 221, 7.8.2001, f. 121.

[3] Opinion i Parlamentit European, datë 14 nëntor 2001 (GZ C 140 E, 13.6.2002, f. 167), Qëndrim i Përbashkët i Këshillit, datë 18 mars 2002 (GZ C 145 E, 18.6.2002, f. 1) dhe Vendim i Parlamentit European, datë 13 qershor 2002 (nuk është botuar ende në Gazetën Zyrtare). Vendimi i Këshillit, datë 28 qershor 2002.

[4] GZ L 26, 31.1.1977, f. 14. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, me Aktin e Anëtarësimit të vitit 1994.

[5] GZ L 19, 28.1.1992, fq. 32.

[6] GZ L 178, 17.7.2000, fq. 1.

[7] GZ L 115, 17.4.1998, fq. 31.

[8] GZ L 228, 16.8.1973, fq. 3. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga direktiva 2002/13/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 77, 20.3.2002, fq. 17).

[9] GZ L 63, 13.3.1979, fq. 1. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga direktiva 2002/12/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 77, 20.3.2002, fq. 11).

[10] GZ L 228, 11.8.1992, fq. 1. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga direktiva 2000/64/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 290, 17.11.2000, fq. 27).

[11] GZ L 360, 9.12.1992, fq. 1. Direktivë e ndryshuar, për herë të fundit, nga direktiva 2000/64/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit.